

# PËRMBLEDHJE E DËGJESËS PUBLIKE

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale

Qarku Elbasan | 28 Prill 2026

## 1. Konteksti dhe kuadri i dëgjësës

Dëgjesa publike në qarkun Elbasan, e zhvilluar më 28 Prill 2026, përbën sesionin e tretë konsultues të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale, pas atyre të Lezhës (22 Prill) dhe Gjirokastrës. Sesioni u moderua nga Valbona Karakaci, Këshilltare Strategjike pranë projektit "Bashki të Forta", dhe u bashkëkryesua nga deputeti Arbjan Mazniku (mazhorancë) dhe deputeti Luçiano Boçi (opozitë). Diskutimi u strukturua sipas tre shtyllave të miratuara: organizimi territorial dhe qeverisja, funksionet dhe kompetencat, financat vendore.

Qarku Elbasan ofron një kontekst të veçantë analitik. Me 437,000 banorë të shpërndarë në 7 bashki Elbasan, Peqin, Gramsh, Librazhd, Prrenjas, Cërrik dhe Belsh. Kombinimi i një kryeqendre të madhe industriale-urbane me zona malore (Gramsh, Librazhd, Prrenjas) dhe fushore-bujqësore (Peqin, Cërrik, Belsh) e bën qarkun një rast studimi të vlefshëm për asimetritë e brendshme të reformës së vitit 2015.

Pjesëmarrësit, përveç bashkëkryetarëve dhe deputetes Jorida Tabaku, përfshinë kryetarë bashkish në detyrë (Gledian Llatja, Elbasan), këshilltarë bashkiakë, ish-kryetarë komunash, akademikë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë nga zonat periferike.

### Karakteristika dalluese e këtij qarku

Qarku i Elbasanit shtrihet mbi një territor me kombinim të theksuar fushor-malor, nga zonat industriale të qytetit deri në fshatrat malorë të Gramshit, Librazhdit dhe Prrenjasit. Ky diversitet gjeografik prodhoi në sallë diferencime të dukshme mes përfaqësuesve urbanë dhe atyre nga zonat rurale.

## 2. Organizimi territorial dhe qeverisja

Çështja territoriale u artikulua rreth një kontrasti të theksuar: nga njëra anë, asimetria strukturore e qarkut e ngritur nga bashkëkryetari Boçi dhe disa ish funksionarë; nga ana tjetër, treguesit pozitivë të investimeve dhe kapacitetit administrativ, të prezantuar nga kryetarët dhe këshilltarët në detyrë. Debati nuk u zhvillua si zgjedhje binare mes "reformë territoriale" dhe "status quo", por si analizë e marrëdhënies mes madhësisë, kapacitetit, shërbimit dhe përfaqësimit demokratik.

### 2.1 Argumentet për rishikim territorial dhe shumëzim njësisht

#### Të dhënat demografike të cituara

Z. Kodhel Cala, këshilltar i Bashkisë Gramsh, paraqiti të dhënat se Gramshi ka humbur sipas tij rreth 10 mijë banorë në dekadën e fundit dhe se asnjë nga ish-komunat e bashkisë nuk ka rrugë asfalti që e lidh me qendrën. Z. Shkëlqim Agolli evidentoi mbylljen e shkollës së Pashtresit, e cila sipas tij kishte 137 nxënës në vitin 2008. Këto të dhëna u paraqitën në sallë si dëshmi që, sipas

folësve, lidhen me strukturën aktuale të qeverisjes vendore. Verifikimi statistikor i tyre përmes burimeve primare mbetet jashtë qëllimit të këtij raporti.

### Referencat krahasuese ndërkombëtare

Z. Stabri Sollaku, ish-kryetar i Shoqatës së Komunave, prezantoi modelin e Republikës Çeke si referencë: rreth 5 milionë banorë jashtë Pragës administrohen nga më shumë se 600 komuna, ndërmjet të cilave njësia më e vogël ka sipas tij 14 banorë. Z. Fatmir Çekrezi argumentoi se modeli evropian bazohet mbi dy nivele qeverisëse vendore (bashki + rajone) dhe se thithja e fondeve të kohezionit kërkon strukturim përkatës rajonal.

### Çështja e përfaqësimit në këshillat bashkiakë

Z. Qamil Boja nga Cerriku ngriti pyetjen mbi përfaqësimin e zonave të largëta nga qendra e bashkisë, duke përmendur zonën e Zavalinës rreth 30 km larg. U evidentua se në qarkun e Elbasanit numërohen rreth 177 këshilltarë në total dhe se sipas disa folësve disa zona rurale nuk kanë përfaqësues të zgjedhur në këshillat bashkiakë.

## 2.2 Argumentet e ngritura në favor të ruajtjes apo konsolidimit së modelit aktual

### Investimet kapitale të realizuara

Z. Faik Gjolena, ish-kryetar komune, argumentoi se kapaciteti investues i bashkive aktuale e ka tejkaluar atë të ish-komunave. Ai përmendi se granti vjetor i një ish-komune të vogël ka qenë rreth 14 milionë lekë, shumë e cila sipas tij nuk mjaftonte për investime kapitale të nivelit aktual. Z. Arben Thura, përfaqësues nga Polisi (Librazhd), raportoi 4 km rrugë të riasfaltuara dhe punime mbrojtjeje nga përmytjet e lumit Gostimë.

### Treguesit financiarë të cituar

Z. Lutfi Lala nga Shpati paraqiti të dhëna mbi rritjen e të ardhurave për frymë në bashkinë e tij — sipas tij, nga afërsisht 46.000 në 160.000 lekë — dhe argumentoi se shërbimet bazë (pastrim, kanalizim, ujësjellës) kanë treguar përmirësim. Z. Mazniku përmendi treguesin kombëtar të raportit pagash ndaj buxhetit total: nga rreth 73% para reformës në rreth 43% sot, duke argumentuar se kjo lëvizje pasqyron rritje të hapësirës së buxhetit për investime, edhe pse pjesërisht është e shoqëruar me shtim të numrit të punonjësve për të mbuluar shërbime të reja.

### Argumenti i kapaciteteve specialistike

Z. Gledian Llatja, kryetar i Bashkisë Elbasan, argumentoi se njësitë me popullsi më të madhe kanë mundësi të punësojnë profile specialistike (inxhinierë, juristë, urbanistë) që njësitë e vogla nuk i mbajnë financiarisht. Sipas tij, cilësia e shërbimeve teknike, sidomos në planifikimin urban dhe menaxhimin e fondeve të donatorëve, është e ndërlidhur me masën kritike të kapacitetit administrativ.

## 2.3 Niveli i dytë i qeverisjes

Niveli rajonal/qark u trajtua si çështje e ngritur përgjatë gjithë sesionit, nga aktorë me pozicione të ndryshme. Z. Stabri Sollaku propozoi që Këshilli i Qarkut të zgjidhet drejtpërdrejt me votë dhe të ketë kompetenca qeverisëse, jo vetëm koordinuese. Z. Fatmir Çekrezi argumentoi që fondet

strukturore dhe të kohezionit të BE-së alokohen mbi bazë rajonesh dhe se rajonet aktuale shqiptare janë funksionalisht të dobëta. Të dy bashkëkryetarët evidentuan rëndësinë e nivelit të dytë në kontekstin e integritimit të ardhshëm europian, edhe pse me theksime të ndryshme: Z. Mazniku evidentoi nevojën e rritjes së kapaciteteve absorbuese të bashkive dhe rajoneve për fondet e kohezionit; Z. Boçi argumentoi se rajonet si nivel i dytë mund të kompensojnë kufizimet e bashkive të vogla në menaxhimin e fondeve europiane.

#### Vërejtje analitike

Krahasimi Elbasan–Gjirokastrë u shfrytëzua nga të dy bashkëkryetarët, por me leximë të ndryshme. Z. Mazniku e ruajti pozicionin metodologjik se diskutimi territorial duhet të vijë pas atij të kompetencave dhe financave. Z. Boçi e përdori si argument në favor të rivlerësimit të numrit të bashkive në qarqet me popullsi të madhe. Kjo ripërsëritje e qasjeve metodologjike, e dokumentuar edhe në dy dëgjesat e mëparshme, sugjeron një ndarje strukturore mes dy qasjeve të analizës së reformës e cila evidentohet konsistent përgjatë procesit konsultativ.

### 3. Funkcionet dhe kompetencat

Seksioni i kompetencave prodhoi konvergencën më të gjerë diagnostike të dëgjesës. Aktorët nga e gjithë spektri politik dhe institucional u shprehën se bashkitë operojnë me disa kompetenca të reduktuara ose të paqarta në krahasim me kuadrin organik të miratuar në vitet 2014–2015. Diferencat mes folësve qëndruan tek shkaqet dhe tek shkalla e rishikimit të nevojshëm.

#### 3.1 Centralizimi i shërbimeve të transferuara

Disa shërbime të transferuara fillimisht të bashkitë janë riqendëruar gjatë viteve të fundit. Diagnostika e këtyre rasteve u paraqit me detaj në sallë:

##### Ujësjetës-kanalizimet

Shërbimi është centralizuar progresivisht në nivel rajonal dhe më pas në Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë. Z. Bajazit Karriqi nga Prrenjasi paraqiti të dhënat se bashkia humbi sipas tij rreth gjysmën e të ardhurave pasi ujësjetësi, shërbim relativisht fitimprurës për bashkinë e tij, kaloi nën menaxhimin rajonal. Z. Asim Çekrezi raportoi për Gramshin se materialet teknike të mirëmbajtjes (manikota, tuba) duhet të vijnë nga Elbasani, gjë që sjell pritje deri në dy ditë për qytetarët në rast prishjeje.

##### Bujqësia

Sektori bujqësor u përshkrua si rast i fragmentimit institucional: veterinerët varen nga Vlora, agronomët nga Lushnja, bordi i kullimit nga Fieri. Z. Qamil Boja evidentoi mosfunksionimin e pastrimit të kanaleve kulluese dhe sistemit të ujitjes në zonën e tij. Diagnostika e ngjashme u paraqit edhe në dëgjesën e Gjirokastrës, çka sugjeron se kjo nuk është specifike e qarkut të Elbasanit, por çështje strukturore me prani të gjerë.

##### Emergjencat civile dhe zjarrfikësit

Z. Llatja paraqiti rastin e zjarrfikësve si shembull të kompetencës së deleguar pa financim adekuat: bashkia mban përgjegjësinë institucionale, ndërsa qeveria qendrore mbulon vetëm

pagat. Pasoja, sipas tij, është që bashkia mbulon shpenzimet operacionale (mjete, karburant, mirëmbajtje) nga buxheti i saj, duke reduktuar burimet për shërbime të tjera.

### Standardet e reja arsimore parashkollore

Standardet e reja për kopshtet dhe çerdhet me psikologë në shkolla, mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe logopedë u cituan si rast tjetër ku rritja e kërkesave nuk është shoqëruar me rritje paralele të financimit.

## 3.2 Hendeku mes kompetencave nominale dhe atyre operative

Hendeku mes kompetencave të sanksionuara në ligjin organik dhe aftësisë reale të bashkive për t'i ushtruar u përsërit në disa folës:

- Një anëtar i këshillit bashkiak të Elbasanit ngriti se kryetarët e bashkive kanë akses të kufizuar në shëndetësi, arsim dhe ujësjellës.
- Z. Arian Çala (shoqëria civile) e formuloi diagnostikën në termat e raportit përgjegjësi/kompetenca, duke argumentuar se rendi aktual është invers.
- Z. Llatja, si zyrtar aktual, konfirmoi se kompetencat e deleguara pa financim përkatës janë kompetenca formale, jo operacionale.

## 3.3 Propozime konkrete operative të paraqitura

Propozimet e ngritura në sallë, regjistruar si zëra të dëgjesës:

- Riintegrimi i menaxhimit të ujësjellësit në nivel bashkie ose rajoni.
- Riintegrimi i shërbimeve bujqësore mbështetëse (veterineri, agronomi, mbrojtje bimësh, kullim) në nivel bashkie ose rajoni.
- Z. Ahmet Mehmeti paraqiti propozimin që zona industriale e Elbasanit të kalojë në kompetencë bashkiake, me referencë ndaj çështjeve të ndotjes dhe pastrimit të tokave.
- Z. Arian Çala kërkoi qartësim të kompetencave për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave.
- Parim i përsëritur nga shumë folës: çdo delegim kompetencash të shoqërohet me financim përkatës.

## 4. Financat vendore

### 4.1 Niveli i financimit të pushtetit vendor

- Z. Boçi paraqiti raportin krahasues ndërmjet 1% të PBB-së që alokohet aktualisht për pushtetin vendor në Shqipëri dhe mesatares prej rreth 14% në vendet e BE-së. Si referencë krahasuese, ai prezantoi modelin gjerman, ku bashkitë financohen nëpërmjet transfertave të strukturuar me 14% të PBB-së dhe ushtrojnë autonomi të plotë vendimmarrjeje mbi përdorimin.
- Z. Mazniku ripërsëriti pozicionin se rritja e kapacitetit absorbues të bashkive dhe rajoneve është parakusht teknik për shfrytëzimin e fondeve të kohezionit dhe atyre strukturore të

BE-së pas pranimit të parashikuar. Sipas tij, ristrukturimi i pushtetit vendor është komponent i nevojshëm për këtë qëllim.

- Sipas të dhënave të cituara nga Znj. Tabaku, rreth 61% e të ardhurave totale të pushtetit vendor përqendrohet në vetëm 10 bashki, duke lënë pjesën tjetër të vendit në varësi të lartë të transfertës qeveritare.

## 4.2 Raporti pagat/investime

---

### Niveli kombëtar

Z. Mazniku evidentoi përmirësimin e raportit kombëtar pagat ndaj buxhetit total: nga rreth 73% para reformës në rreth 43% sot. Ai e paraqiti këtë si tregues të rritjes së hapësirës fiskale për investime, duke pranuar se shtimi i shërbimeve të reja (kopshte, çerdhe, infrastrukturë) ka kërkuar shtim të stafit operacional.

### Niveli vendor

Z. Artan Kana, këshilltar në Bashkinë Elbasan, paraqiti të dhëna të nivelit vendor: 79% e të ardhurave të bashkisë shkojnë për paga dhe shpenzime operative, ndërsa 21% janë në dispozicion për investime.

### Rritja e numrit të punonjësve

Disa folës ngritën të dhëna mbi rritjen e administratës pas reformës:

- Prof. Albert Kurti për Peqinin: nga 132 punonjës në 2015 (5 ish-komuna + bashkia ekzistuese) në 328 sot.
- Z. Mazniku, ndërkohë, evidentoi se rritja e numrit të stafit duhet vlerësuar në kontekstin e shërbimeve të reja të marra në kompetencë (kopshte, çerdhe, pastrim, etj.) — pra si pjesërisht funksionale, edhe pse përqindja vlen të analizohet me detaj.

## 4.3 Modelet krahasuese të autonomisë fiskale

---

Znj. Tabaku argumentoi se një përqindje e taksave kombëtare të mbledhura në një territor duhet të mbetet në atë territor. Si rast specifik për Elbasanin, ajo evidentoi se ky qark gjeneron të ardhura nga burimet natyrore dhe industria, ndërkohë që pasojat (ndotja, ngarkesa infrastrukturore) mbahen nga komuniteti vendor.

## 4.4 Granti i kushtëzuar dhe i pakushtëzuar

---

U riargumentua nga disa folës parimi i autonomisë vendore sipas Kartës Europiane: granti duhet të ketë komponent të lartë të pakushtëzuar, duke i lënë bashkisë vendimmarrjen mbi prioritetet e shpenzimit. Sipas pjesëmarrësve, struktura aktuale me dominim të grantit të kushtëzuar redukton fleksibilitetin e bashkive për t'iu përgjigjur nevojave specifike vendore.

## 4.5 Perspektiva europiane

---

Diskutimi mbi përgatitjen për integrimin europian prodhoi qasje të diferencuara mes dy bashkëkryetarëve. Z. Mazniku argumentoi se afria e pranimit në BE krijon urgjencë teknike për bashki dhe rajone të afta të menaxhojnë fonde strukturore dhe të kohezionit, duke konsideruar reformën si komponent të domosdoshëm të kësaj përgatitjeje. Z. Boçi paraqiti një lexim alternativ të precedentit, duke cituar rastin e Kroacisë, e cila sipas tij hyri në BE me afërsisht 560 njësi vendore, duke argumentuar se faktori vendimtar është administrata e trajnuar dhe rajonet funksionale, jo madhësia e bashkive.

## 5. Divergjenca e qëndrimit: zyrtarë në detyrë dhe zëra të tjerë

Edhe në Elbasan, ngjashëm me sesionet e mëparshme, evidentohet një ndarje pozicionale ndërmjet zyrtarëve aktualë dhe pjesëmarrësve të tjerë. Megjithatë, intensiteti dhe karakteri i kësaj ndarjeje paraqesin nuanca specifike që meritojnë regjistrim.

### 5.1 Zyrtarët aktualë në detyrë

Kryetarët e bashkive dhe këshilltarët në detyrë (Z. Llatja — Elbasan; përfaqësues nga Cerriku, Polisi, Shpati, Belshi) shfaqën tipare konsistente:

- Përmendje e investimeve të realizuara — asfaltime, kanalizime, infrastrukturë e përmirësuar.
- Pranim i problemeve strukturore (centralizim, kompetenca të reduktuara), pa formulim të reformës si tërësisht të dështuar.
- Theksim i përmirësimit të treguesve financiarë në nivel kombëtar (raporti 73%→43%).
- Kërkesa për forcim të kompetencave dhe financave, me rezervë ndaj ristrukturimit territorial të menjëhershëm.

### 5.2 Përfaqësuesit ruralë dhe ish-zyrtarët

Pjesëmarrësit pa funksion aktual (Z. Cala, Prof. Kurti, Z. Sollaku, Z. Çala, Z. Çekrezi,) shfaqën qëndrime kritike:

- Kërkesë e shprehur për reformë territoriale, sidomos përmes rritjes së numrit të bashkive ose rikthimit të disa ish-komunave.
- Të dhëna mbi infrastrukturën rurale: rrugë të paasfaltuara në ish-komunat e Gramshit, kanale kulluese të papastruara, ujitje jofunksionale në Pajovë.
- Vërejtje mbi përqendrimin e investimeve në qendrat urbane në krahasim me zonat periferike.

## 6. Pikat e konvergjencës

Përtej ndarjeve, sesioni evidentoi pika konvergjece mes pozicioneve të ndryshme:

- Parimi që çdo delegim kompetencash duhet të shoqërohet me financim përkatës u shpreh nga aktorë të të gjitha pozicioneve.

- Procesi i centralizimit u trajtua si problematik nga disa folës, përfshirë kryetarët e bashkive aktualisht në detyrë. Diferencat mes folësve qëndruan tek shkalla e propozuar e rikthimit të kompetencave, jo tek diagnostika bazë.
- Lëvizja e popullsisë së zonave rurale u trajtua si shqetësim nga disa pjesëmarrës, edhe pse shkaqet e atribuara variojnë mes folësve.
- Forcimi i nivelit rajonal/qark me kompetenca reale u përmend nga aktorë të shumtë. Diferencat qëndrojnë tek modeli (kryetar i zgjedhur me votë vs. përfaqësim i deleguar) dhe tek perimetri territorial (qarqe ekzistuese vs. rajone të reja).
- Konsensusi mbi karakterin konsensual të reformës: të dy bashkëkryetarët dhe pjesëmarrës nga grupime të ndryshme theksuan se produkti final i Komisionit duhet të jetë i qëndrueshëm përtej ciklit të vetëm elektoral.

## 7. Mesazhet kryesore të dëgjesës

Bazuar në materialin e ngritur në sallë dhe në krahasimin me dy sesionet e mëparshme, regjistroheshen pesë gjetje me peshë analitike:

### M1 — Fragmentimi institucional i sektorit bujqësor është strukturor

Diagnostika e fragmentimit të shërbimeve bujqësore (veterineri, agronomi, kullim, mbrojtje bimësh të varura nga qarqe të ndryshme) u paraqit edhe në sesionin e Gjirokastrës. Përsëritja e këtij konstatimi në dy qarqe me strukturë gjeografike dhe ekonomike të ndryshme sugjeron se nuk është specifikë e qarkut të Elbasanit, por çështje strukturore me prani të gjerë. Trajtimi i saj kërkon koordinim mes Komisionit dhe ministrive sektoriale.

### M2 — Argumenti i ekonomive të shkallës

Argumenti se njësitë më të mëdha kanë kapacitet specialistik më të lartë dhe fuqi ekonomike më të qenësishme për të ushtruar funksione (Z. Llatja). Historia krahasuese mes mundësive që kishin ish komunat dhe mundësive të reja që kanë sot bashkitë (sidomos ato me territor dhe popullsi të madhe) është e dukshme për qytetarët.

### M3 — Ka të dhëna të paraqitura mbi humbjen e popullsisë në zonat e qarkut pas vitit 2015

Të dhënat e cituara në sallë (Gramshi sipas Z. Cala, mbyllja e shkollës së Pashtresit) sugjerojnë lëvizje demografike negative në zonat rurale. Atribuimi shkakor sa e si ka kontribuar reforma në këto lëvizje krahasuar me faktorë të tjerë (emigrimi, ndryshimet ekonomike, papunësia) kërkon analizë të specializuar dhe verifikim me burime primare statistikore. Megjithatë, sinjali mbetet relevant për diagnostikën e gjendjes aktuale.

### M4 — Autonomia financiare reale u trajtua si parakusht funksional

Përtej diferencave mes qasjeve metodologjike të dy bashkëkryetarëve, mes folësve të tjerë dhe mes grupeve pozicionale, autonomi financiare reale, qoftë përmes rritjes së transfertës strukturore, qoftë përmes zgjerimit të bazës tatimore vendore, u trajtua si kusht funksional për operativitetin e kompetencave dhe për qëndrueshmërinë e çdo modeli territorial. Modelet krahasuese të paraqitura (suedez, gjerman) ofrojnë alternativa teknike të dokumentuara, dallimet mes të cilave kërkojnë analizë të mëtejshme.

## 8. Çështje të identifikuara nga sesioni

Përtej gjetjeve analitike, sesioni nxori një sërë çështjesh konkrete që janë regjistruar si të hapura dhe që mund të trajtohen në fazat e mëtejshme të punës së Komisionit:

- Çështja e një kufiri ligjor mbi përqindjen e buxhetit të dedikuar për paga dhe shpenzime operative.
- Çështja e riintegritit të shërbimeve bujqësore mbështetëse nën autoritet vendor ose rajonal.
- Analizë krahasuese e modeleve fiskale (suedez, gjerman, dhe të tjera relevante) për vlerësimin e zbatueshmërisë në kontekstin shqiptar.
- Modeli i nivelit të dytë të qeverisjes (kryetar i zgjedhur me votë vs. përfaqësim i deleguar; qarqe ekzistuese vs. rajone të reja).
- Mekanizma kompensues për bashkitë që mbajnë infrastrukturë me eksternalitet rajonal (zona industriale, zona të mbrojtura, ngarkesa sezonale).

### Shënim metodologjik

Ky raport është hartuar si dokument ekspert i pavarur, mbi bazën e materialit të dëgjuesës publike të Elbasanit (28 Prill 2026), duke aplikuar metodologjinë e standardizuar të hartuar pas pilotimit të Lezhës dhe të rafinuar pas sesionit të Gjirokastrës. Ai përfaqëson zërat e shprehur gjatë sesionit, me kujdes për balancimin mes qasjeve divergjente. Raporti nuk paraqet rekomandime: kufizohet në regjistrimin e gjetjeve dhe në analizë të thjeshtë të tyre. Shifrat e cituara nga folësit (popullsi, buxhete, raporte paga/investime, treguesit krahasues europianë) trajtohen si deklarata të pjesëmarrësve dhe kërkojnë verifikim nga burime primare para përdorimit në dokumentet finale të Komisionit. Atribuimi i argumenteve është bërë me kujdes; kur folësi nuk ishte i identifikueshëm me siguri, atribuimi u bë te grupi profesional ose institucional. Transkripti i plotë dhe ky raport do të jenë publike në faqen e Kuvendit.